



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT
TË PUSHTETIT LOKAL



KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE



AUDITIMI SOCIAL

KOMUNA E DRENASIT
JANAR, 2025



PËRMBAJTJA

RRETH KLGI.....	5
RRETH MAPL.....	5
HYRJE.....	6
PROFILI I KOMUNËS.....	7
KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL.....	8
PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL.....	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	11
METODOLOGJIA.....	11
RRETH PROJEKTEVE.....	13
GJETJET KRYESORE.....	14
REKOMANDIME.....	15
KOMENTET E KOMUNËS.....	16
LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL.....	17

RRETH KLGI

Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) është organizatë profesionale e dedikuar për të përmirësuar dhe forcuar qeverisjen lokale në Kosovë.

KLGI është themeluar në vitin 2008 bazuar në modele ndërkombëtare të organizatave profesionale. Instituti synon të kontribuojë në vazhdimësinë e procesit të reformave në çështjet e qeverisjes lokale dhe të avancojë sistemin e decentralizuar të qeverisjes, me theks të veçantë në rritjen e llogaridhënies dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal.

Fokusi i KLGI-së është në konsolidimin demokratik dhe mirëfunksionimin e institucioneve të nivelit lokal lidhur me praktikat dhe trendet bashkëkohore. Në këtë perspektivë, KLGI-ja është aktive përmes hulumtimeve, avokimit, rrjeteve, këshillave për politika publike, ngritjen e kapaciteteve dhe forma të tjera të mbështetjes për qeverisjen lokale.

RRETH MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është institucion i administratës shtetërore të Republikës së Kosovës, e themeluar në vitin 2004. Funksionin e saj, MAPL-ja e ushtron në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Përgjatë këtyre viteve, MAPL-ja ka qenë direkt e përfshirë në procesin e reformës së pushtetit lokal, respektivisht shtrirjen e procesit të decentralizimit në vend, sigurimit të kompetencave të mjaftueshme të pushtetit lokal dhe ushtrimit të tyre në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm. MAPL-ja ndjek një politikë të afirmimit të të drejtave të komunave në rregullimin e çështjeve publike, krijimit të kapaciteteve të mjaftueshme të komunave për të ushtruar veprimtarinë e tyre në pajtim me parimin e ligjshmërisë, subsidiaritetit, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit dhe parimeve të tjera të qeverisjes së mirë.

Misioni i Ministrisë është të rritet autonomia lokale dhe të forcohet aftësia e komunave, që nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve dhe përfaqësimit demokratik, të ofrohen shërbime me kosto efektive për të rritur cilësinë e jetës, sigurinë dhe ekonominë lokale.

HYRJE

Auditimi Social i zbatuar nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI) dhe i mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Projekti i audituar nga grupi:

1. Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas- projekt trevjeçar

Raporti paraqet metodologjinë e zbatuar nga Grupi i Auditimit Social, përfshirë:

- i. Mbledhjen e informacionit; sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave dhe krahasimet me modelet dhe standardet;
- ii. Monitorimin në terren; takimet me përfitues dhe informacione rrethimore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë);
- iii. Hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. Adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën.

Ky aktivitet është mbështetur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në Kosovë, që ka për qëllim forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive gjithëpërfshirëse dhe kohezive.

Instituti KLGI, nëpërmjet Auditimit Social ka tri synime:

1. Rritjen e informacionit dhe njohurive për Auditimin Social;
2. Përfshirjen e qytetarëve në proceset publike lokale;
3. Ndërtimin e praktikave për angazhim të vazhdueshëm publik.

PROFILI I KOMUNËS

Drenas

Zona dhe Popullsia

Komuna e Drenasit gjendet në zonën qendrore të Kosovës. Përfshin një sipërfaqe prej 276 km² me 49 fshatra dhe vendbanime. Sipas Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës 2024, popullsia e përgjithshme është **48,079** banorë rezidentë.

Struktura Qeverisëse dhe Pasqyra Politike

Numri i përgjithshëm i votuesve në Komunën e Drenasit, të regjistruar për zgjedhjet e fundit komunale të mbajtura në tetor 2021 ishte 54,948 duke përfshirë votuesit jashtë Kosovës. Pjesëmarrja në votime ishte 42.9 për qind/20.855 votues (burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve).

Përbërja e Kuvendit Komunal nga Zgjedhjet Lokale 2021:

1. Legjislativi

Kuvendi Komunal: **31 ulëse**

Rezultatet e zgjedhjeve:

PDK – Partia Demokratike e Kosovës	
45.01%	14
Demokratet për Drenasin	
24.25%	8
LVV – Lëvizja Vetëvendosje	
16.99%	2
Iniciativa Qytetare Green për Drenas	
5.58%	2
AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	
3.84%	1
LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës	
1.58%	1

2. Ekzekutivi

Kryetari i Komunës: **Ramiz Lladrovci (PDK)**

Drejtoritë e Komunës: **12**



TË ARDHURAT BUXHETORE

Kategoria	Vlera
a. Të hyrat vetanake	1,936,467
b. Granti i Përgjithshëm	9,439,381
c. Granti Specifik për Arsim	8,232,004
d. Granti Specifik për Shëndetësi	2,525,698
Totali	22,133,550

BUXHETI NË KATEGORI

Kategoria	Vlera
a. Pagat dhe shtesa	11,497,909
b. Mallra dhe shërbime	2,622,703
c. Shpenzime komunale	346,749
d. Subvencionet dhe transferet	594,000
f. Investimet kapitale	6,956,940

Komuna e Drenasit ka:

*Buxhet total: **22,133,550 Euro***

*Staf komunal: **1,388***

KONCEPTI I AUDITIMIT SOCIAL


Auditimi Social është njëri nga mjetet e informimit, përfshirjes dhe angazhimit qytetar në proceset komunale. Si dhe njëra nga metodat e kontributit konstruktiv të akterëve (qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit), në veçanti e përfituesve fundorë të investimeve komunale.

Ky proces synon të kontribuojë reciprokisht në dy dimensione: në njërën anë, të zgjerojë informacionin, njohuritë dhe përfshirjen e qytetarëve në të gjitha stadet e zhvillimit të investimeve komunale (planifikim, zbatim, monitorim si dhe vlerësim) dhe në anën tjetër, të rrisë interesin e autoriteteve lokale për të forcuar pronësinë dhe kontributin direkt të qytetarëve në investimet komunale. Në fokus, për të rritur nivelin e performancës së komunave në të gjitha stadet e investimeve kapitale nëpërmjet kontributit dhe monitorimit qytetar.

Auditimi Social është në frymën e parimeve të qeverisjes së mirë, duke siguruar se autoritetet lokale, marrin parasysh nevojat, kërkesat dhe interesat publike në proceset e politik-bërjes dhe vendimmarrjes komunale. Si dhe duke siguruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social në komuna. Auditimi Social merr kuptim të plotë, atëherë kur publiku ka informacion, është i përfshirë dhe ka rol në proceset e politikave lokale. Përtej mjeteve dhe mekanizmave të zakonshëm, Auditimi Social, ka karakterin e bashkë-dizajnit dhe bashkë-krijimit të politikave lokale. Si hisedar, ai merr edhe rolin e monitoruesit dhe vlerësuesit të zbatimit dhe ndikimit real të investimeve komunale. Kështu, synimi parësor është të forcojë besimin reciprok në mes qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Instituti KLGI, përgjatë këtij cikli të Auditimit Social, ka vendosur në fokus që pronësia e procesit të bartet tek organizatat dhe aktivistët lokalë, kjo duke siguruar qëndrueshmëri dhe vazhdimësi të proceseve. E, njëkohësisht, që t'i ofrojë nivelit lokal metodologji, mjete dhe kapacitete, për të shtrirë Auditimin Social edhe në projektet tjera komunale.

Për të siguruar qasje sa më efektive në zbatim, Instituti KLGI, është angazhuar në tri (3) dimensione: i. grupet e auditimit të reflektojnë gjithëpërfshirjen e qytetarëve; ii. njohja e vlerave dhe interesave të komunitetit lokal; iii. ndërthurja e dy të parave me proceset, praktikat dhe mekanizmat komunalë.



PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL

Themelimi i Grupit të Auditimit Social/Trajnimit

Grupi i Auditimit Social ka përfshirë një ekip gjithëpërfshirës të përbërë nga qytetarë që përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe kontribuojnë në vlerësimin e projekteve publike si: banorë ose përdorues të shërbimeve publike, ekspertë teknikë, inxhinierë apo ekonomistë, përfaqësues të shoqërisë civile, grupe të rinjve e të komuniteteve tjera. Diversiteti i anëtarëve ka siguruar që vlerësimi të jetë gjithëpërfshirës dhe të adresojë si aspektet teknike, ashtu edhe ato sociale dhe ekonomike të projektit të audituar. Grupi i Auditimit Social ka qenë i fokusuar në mbledhjen e të dhënave, inspektimin e punimeve dhe përfshirjen e komunitetit në proces, duke nxitur pjesëmarrjen qytetare. Përmes këtyre aktiviteteve, Grupi i Auditimit Social ka ndihmuar në identifikimin e problematikave dhe në sigurimin që projekti që është në zbatim të përmbushë nevojat dhe pritshmëritë e komunitetit.

Takimi i parë

Fillimisht, me datë: **28 qershor 2024** u zhvillua takimi koordinues dhe trajnimi për gjashtë (6) organizatat partnere të përfshira në procesin e Auditimit Social. Ndërsa, nëpërmjet letrës informuese, me datë: **7 korrik 2024**, është njoftuar komuna e Drenasit mbi projektet e përfshira dhe organizatën partnere lokale që do ta zbatojë Auditimin Social. Më datë: **22 korrik 2024**, është themeluar grupi i Auditimit Social dhe është mbajtur takimi i parë/trajnimi. Në takim morën pjesë 12 qytetarë, prej tyre 10 burra dhe 2 gra. Njëkohësisht u zhvillua trajnimi mbi auditimin social i ndarë në tri sesione (njohja e legjislacionit mbi qeverisjen lokale; konceptet dhe metodologjia e auditimit social; shembujt dhe praktikët dhe analiza e kontratës). Para nisjes së procesit, Grupi i Auditimit Social ka marrë informacione dhe njohuri të thelluara mbi funksionimin e qeverisjes lokale në Kosovë, mekanizmat e pjesëmarrjes dhe proceset e auditimit social. Auditimi Social në Drenas është zhvilluar në partneritet me Institutin KLGI dhe Center for Education and Development of Environment- CEDE.

Takimi i dytë – punëtori për shqyrtimin dhe analizimin e dosjes së kontratës së projektit

Takimi i dytë është mbajtur me datë: **21 shtator 2024**, ku pjesëmarrës nga grupi ishin 15 persona. Në këtë takim u punua drejtpërdrejt mbi dokumentacionin e kontratës së projektit, i cili është subjekt monitorimi. Ky dokumentacion ka përfshirë gjithë dosjen tenderuese, duke përfshirë planin ideor, specifikat teknike, shpalljen për ofertues, përzgjedhjen e operatorit përfitues, planin dinamik si dhe dokumente tjera përcjellëse. Fillimisht, u reflektua mbi metodologjinë, stadin e zbatimit të kontratës, analiza e përgjithshme, kriteret, parimet dhe standardet e investimit publik. Po ashtu, u vendosën fokuset e trajtimit nga grupi i auditimit. U ndanë rolet: mbajta e shënimeve, vrojtimit (mjedisi, pjesa inxhinierike, ndjeshmëria gjinore, grupeve të cënueshme, bizneset); fotografimi i gjetjeve. Grupi ishte aktiv dhe konstruktiv, pjesëtarë, të cilët evidentuan disa nga pikat e kontratës, që duhet fokusuar gjatë vizitës në terren. Në këtë takim, u diskutuan dhe dakorduan edhe hapat e mëtejshëm të procesit të Auditimit Social nga grupi.

Takimi i tretë – Vizita në terren dhe nxjerrja e gjetjeve dhe rekomandimeve

Takimi i tretë është mbajtur me datë: **19 dhjetor 2024**, ku grupi i Auditimit Social ka vizituar punimet në terren. Përveç anëtarëve të grupit të Auditimit Social, në monitorimet në terren u bashkuan edhe qytetarë që rastisën të jenë në vendpunishte. Edhe pse punimet dhe projekti ende janë në proces, u mblodhën dëshmi të mangësive, të cilat janë të dukshme edhe në këtë fazë. Gjetjet janë analizuar secila veç e veç duke krahasuar me specifikat teknike të kontratës dhe realizimit në terren. Pas kësaj, janë listuar gjetjet dhe rekomandimet, të cilat janë diskutuar brenda grupit të auditimit social në Drenas.

Takimi me komunën - Adresimi, konfirmimi i gjetjeve dhe ndarja e rekomandimeve

Takimi i katërt me komunën është mbajtur me datë: **22 janar 2025**. Grupi i Auditimit Social në Drenas ka ndarë gjetjet dhe rekomandimet me Kryetarin e Komunës dhe ekipin, për projektet e monitoruara.

Në takim, prezent ishin edhe kompania zbatuese. Ku u diskuan gjetjet dhe u ndanë rekomandimet e projektit të përfshirë në këtë proces të monitorimit. Më datë: **30 janar 2025**, komuna ka kthyer komentet me shkrim të cilat janë shqyrtuar nga Grupi i Auditimit Social, si dhe janë reflektuar në raportin final.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës **qershor 2024 - shkurt 2025**, Instituti KLGI me mbështetjen nga MAPL, ka zbatuar procesin e Auditimit Social në gjashtë (6) komuna, pjesë e financimit nga Granti i Performancës komunale, përfshirë edhe Drenasit.

Në Komunën e Drenasit ka kaluar në procesin e Auditimit Social projekti:

1. “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci Drenas - projekt trevjeçar”

Instituti KLGI ka përzgjedhur koordinatorin për komunën e Drenasit, duke e përfshirë në platformën www.klgi-platform.com, ku janë ndarë dhe zbatuar detyrat në këtë sekuencim: Koordinatorët, pas vlerësimit të shtrirjes gjeografike të projekteve si dhe strukturës së tyre, kanë identifikuar dhe përzgjedhur qytetarët (aktivistë, pjesë e shoqërisë civile, anëtarë të Këshillave Lokalë, profesionistë, përfaqësues apo direkt pjesëtarë të grupeve të nën-përfaqësuar dhe përfitues fundorë); Instituti KLGI dhe koordinatori, kanë përcaktuar dhe përgatitur takimin e parë/trajnimin, ku më pas është rivlerësuar për nevojën e zgjerimit të grupit pas analizimit fillestar të projektit si dhe kanë krijuar grupin e komunikimit elektronik; Koordinatorin dhe grupin kanë përcaktuar takimet e dyta/vizitat në terren, duke konsultuar përfituesit dhe marrë informacione rrethana nga bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë; Pas mbledhjes së informacioneve nga terreni, në takimin e tretë, janë hartuar gjetjet dhe nxjerrë rekomandimet; Në takimin me komunën janë adresuar gjetjet dhe janë paraqitur rekomandimet nga procesi i Auditimit Social.

Grupi i Auditimit Social, në projektin "Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci - Drenas" ka vendosur në fokus tri elemente: projektimi dhe zbatimi në terren; qasjen dhe kufizimet që krijon ndërtimi i sheshit; funksionalitetin e sheshit.

Sa i përket projektimit dhe zbatimit në terren, nga punimet e zhvilluara deri në këtë fazë, del se kompania punëkryese, është siguruar që të krijojë qasjet e nevojshme infrastrukturore rreth sheshit (nëpërmjet kanaleve të instalimeve). Megjithatë, në pjesën e punimeve ku janë vendosur pllakat, në projektin vlerësohet se nuk është marrë parasysh konfiguracioni i terrenit, ku punë kryesi është shtyrë të përshtat uljen e nivelit për t'u mundësuar qasje lokaleve. Si rrjedhojë, shtrohet edhe shqetësimi i përdoruesve se në rastet kur ka reshje shiu, a do të mjaftojë sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferikë. Sa i përket infrastrukturës nëntokësore, janë planifikuar ri-vitalizmi i rrjetit në mënyrë që të shmangen ndërhyrjet në shesh.

Sa i përket qasjes dhe kufizimeve, grupi i Auditimit Social, ka vendosur fokusin në dy pozicione: e para, ka të bëjë me atë se cili do të jetë ndikimi në mobilitetin urban me mbylljen e rrugës “Bedri Shala”, duke marrë parasysh se ajo është një kapilar i rëndësishëm që lidhë institucione si Qendra e Mjekësisë Familjare dhe pjesë të tjera të qytetit; dhe e dyta, ka të bëjë me qasjen në shesh të qytetarëve nga pjesa te lokalet apo nga rruga që lidhë me Qendrën e Mjekësisë Familjare.

Përderisa, sa i përket funksionalitetit, sheshi paraqet njërin prej projekteve më gjithëpërfshirëse, duke krijuar hapësira për ecje, qëndrim, aktivitete për të gjitha grupet shoqërore. Mbi të gjitha, paraqet një projekt estetik urban, në veçanti këndet për ngjarje publike, kiosqet dhe hapësirat për rekreacion. Vlerësohet e nevojshme të shtohen si pjesë e investimit edhe WC publike.

**Detajet janë të paraqitura në pjesën e gjetjeve, rekomandimeve dhe komenteve të komunës.*

HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Procesi i Auditimit Social, referohet në metodologjinë e punës përfshirë:


- i. **Mbledhjen e informacionit** – sigurimin e kontratave; analizimin e kontratave sipas parametrave, krahasimet me kriteret, parimet dhe standardet;
- ii. **Vizitat/monitorimin në terren** – takimet me përfitues dhe informacione rrethimore (bizneset, qytetarët e rastit si dhe specialistë) dhe komentet e anëtarëve të grupit;
- iii. **Puna e grupit të Auditimit Social** – hartimin e gjetjeve dhe rekomandimeve;
- iv. **Takimi në Komunë** – adresimin/konfirmimin e gjetjeve në takimin me komunën dhe ndarja e rekomandimeve.

METODOLOGJIA

Përzgjedhja e Projekteve, Komunave dhe Grupit të Auditimit

Instituti KLGI, referuar **Aneksit I**, të kontratës (KLGI – MAPL) duke marrë listën e projekteve të bashkëfinancuara nga MAPL dhe Komunitat në kuadrin e Grantit të Performancës Komunale me nga dy projekte. Ky rregull ka vlejtur në tri (3) komuna (*Viti, Skënderaj dhe Kaçanik*), me nga një (1) projekt tri (3) komuna (*Drenas, Shtime dhe Ranillug*). Komunitat ku është kryer Auditimi Social, ofrojnë një pasqyrim të kontekstit të përgjithshëm lokal, duke pasur parasysh, se përfshihen komuna të mëdha, të vogla, komuna kufitare, me shtrirje të madhe dhe të vogël gjeografike dhe me përfaqësim të ndryshëm të komuniteteve etnike.

Instituti KLGI, procesin e përzgjedhjes së grupeve të Auditimit Social e ka shtrirë në tri nivele dhe dimensione: i. përzgjedhja e koordinatorëve, aktivistë apo të angazhuar në komunitetin lokal; ii. gjithëpërfshirja (diversiteti) brenda grupit të Auditimit Social; dhe iii. zgjerimi i grupit të Auditimit Social, sipas kontekstit dhe strukturës së projekteve të monitoruara (parqe, rrugë, terrene sportive, investime në ambient), duke siguruar edhe përfshirjen e përfituesve fundorë.



Fokusi i Grupit të Auditimit Social në Drenas

Në projektin "Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci Drenas" fokusi është vendosur: në projektimin dhe zbatimin në terren, qasjen dhe kufizimet që mund të krijojnë projekti dhe funksionalitetin.

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga grupi i Auditimit Social në Komunën e Drenasit:

- Kontratat me detaje janë gjetur në ueb faqen e komunës si dhe janë dërguar në e-mail.
- Investimi ka pasur projekt të detajuar përfshirë edhe pjesët vizuale.
- Punimet nuk janë realizuar brenda afatit kohor të paraparë.

Indikatorët e performancës së përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektet e monitoruara janë:

1. A ndoqi zbatimi një plan të qartë veprimi?
2. A ka pasur vonesa në zbatimin e projektit?
3. Nëse po, cilat ishin arsytet e vonesës?
4. Si është realizuar buxheti në relacion me planin?
5. Nëse ka pasur devijime, cilat ishin arsyetimet për çdo devijim buxhetor?
6. Cilat janë rekomandimet për të përmirësuar më tej projektin?
7. A është krijuar dhe/ose përdorur ndonjë mekanizëm ankesash gjatë zbatimit?
8. A ka ndonjë ankesë të veçantë në lidhje me projektin në fjalë?

Përtej indikatorëve të vlerësimit të zbatimit, monitoruesit kanë nxjerrë të dhëna edhe për ndikimin në mjedis:

1. A ndikon projekti në degradimin e mjedisit?
2. A ndikon projekti në cilësinë e ujit?
3. A ndikon projekti në florë ose faunë?
4. A ndikon projekti në rritjen/zvogëlimin e dioksidit të karbonit?

Indikatorët e veçantë lidhur me projektet janë:

1. A ka pasur probleme përgjatë zhvillimit të punimeve si rezultat i zhvendosjes apo i punimeve nëntokësore (rrjetin e ujësjellësit dhe atmosferik) si dhe a ka pasur vonesa/pengesa në zhvendosjen e rrjetit eklektik?
2. A ka ndikuar projektimi në kryerjen e punimeve, apo ri-përshtatjen në zbatim. A janë këto ndryshime të përshtatshme (zgjidhje) për problemet e evidentuara?
3. Si planifikohet të ofrohet qasje për banorët, por edhe qytetarët nga pjesa e lokaleve, apo rruga që lidhë me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në shesh?
4. Cila propozohet të jetë zgjidhja për rrugën aktuale "Bedri Shala", a janë duke u shqyrtuar opsione për të krijuar një lëvizje të sigurt, por që nuk prek funksionalitetin e sheshit?
5. A janë duke u shqyrtuar propozimet, që brenda kiosqeve, apo si pjesë të veçanta të vendosen WC publike?
6. Si planifikohet të prodhohet zgjidhja për parkingje, nga praktika në qytetet tjera, mungesa e parkingjeve afër shesheve, po rrezikon qasjen dhe bizneset në ato pjesë?
7. Si propozohet të zgjidhet çështja e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të hapësirave në shesh?

RRETH PROJEKTEVE

Projekti	“Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xhevë Lladrovci Drenas - projekt trevjeçar” Numri i prokurimit: 611-23-2223-5-1-1
Çmimi total i punëve në kontratë	4,388,178.38 €
Burimet e financimit	MAPL- 916,388.80 €; DEMOS- 1,118,387.08 €; Komuna- 2,353,402.50 €
Statusi i kontratës	Në proces

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Drenasit

Zbatues: ILEAA – GR SH.P.K; DELTA – CCD SH.P.K; FRONI SH.P.K, Prishtinë

Shënim: Sipas kontratës, projekti ka një vlerë investive prej 4,388,178.38 euro. Kjo vlerë mbulohet nga tri burime të financimit. Komuna e Drenasit mbulon 54% të shumës totale, MAPL 21% dhe DEMOS 25%.

RIKAPITULIM I PËRGJITHSHËM

NR.	Kategoritë	Shuma
1	Punët parapërgatitore	311,398.00 €
2	Punët e demolimit dhe zhvendosjeve	561,223.55 €
3	Punët ndërtimore dhe mbushja	1,095,642.50 €
4	Punët e mveshjes finale	1,144,582.00 €
5	Punët e elementeve mikrourbane	75,210.00 €
6	Punët e fontanës	202,210.00 €
7	Punimi i kiosqeve	205,600.00 €
8	Punët e gjelbërimit	163,803.00 €
9	Punët metalike	227,867.00 €
10	Punët e instalimeve hidroteknike	-
11	Punët e instalimeve të ndriçimit	-
12	Punët e ndryshme	10,000.00 €
13	Punimet e ujësjellësit dhe mbrojtjes nga zjarri	64,133.00 €
14	Kanalizimi fekal	53,496.16 €
15	Kanalizimi atmosferik	118,814.18 €
16	Paramasa e instalimeve elektrike	154,199.00 €
	Totali	4,388,178.38

GJETJET KRYESORE

Në komunën e Drenasit, projekti “Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit Fehmi e Xheva Lladrovci Drenas”, i cili është audituar nga grupi ynë është projekt trevjeçar. Projekti, si i tillë paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, funksionalitet si dhe hapësira shumë dimensionale për përdorim (lodra, ngjarje publike, kiosqe). Si i tillë ai është ende në proces, dhe sipas planit dinamik të punimeve ai parashihet të përfundojë në fund të vitit 2025. Megjithatë, duhet pasur parasysh, disa elemente si qasja/kufizimet, funksionaliteti si dhe zgjidhjet përtej projektimit.

Aktualisht, punimet të cilat janë duke u zhvilluar në terren, i kanë mundësuar grupit të auditimit social të zhvillojë një vlerësim fillestar të ecurisë së punimeve dhe cilësisë së tyre. Deri në këtë fazë të punimeve, krahasuar me planin fillestar, specifikave teknike dhe vështrimit vizual nga grupi i auditimit social, janë evidentuar disa gjetje:



Vendosja e pllakave në disa pozicione, prishë estetikën – Kjo përfshinë anësoret, pllakat e mëdha si dhe kubëzat e vogla (kalldrëm). Anësoret nuk janë të vendosura në formë rrethore – harqe sipas planit vizual të sheshit. E njëjta vlen edhe për pllakat e mëdha, të cilat nuk janë prerë në formë rrethore, por në vijë të drejtë, për shkak të lehtësisë së punës. Pjesa e kubëzave të vogla, nuk janë të shtruara në formë të njëtrajtshme ku drejtimi dhe rreshtimi i tyre nuk janë në linja të drejta dhe të rregullta.



Sistemi i kullimit të ujit atmosferik, i pa përshtatshëm - Ujëmbledhësit e vendosur në hapësirat e sheshit konsiderohet se mund të jenë të pamjaftueshëm, si pasojë nuk mundësojnë përcjelljen e mjaftueshme të ujit në kanalet e shkarkimit. Në kushte me mot (me reshje të dendura), kanalet janë të pamjaftueshme. Duke marrë në konsideratë ndryshimet klimatike, në kushtet me mot


ekstrem, potenciali për vërshime nëpër lokalet afariste pranë sheshit mbetet i lartë.




Mungesa e lidhjes së shkarkuesve të ujit me ujëmbledhës – Përdërisa, pranë lokaleve afariste nuk ka ujëmbledhës të dedikuar për shkarkim të ujërave atmosferikë nga ulluqet e lokaleve afariste. Në mungesë të saj, bizneset vendosin gypat e sistemit të tyre të grumbullimit të ujërave atmosferikë drejtpërdrejt mbi pllakat e sheshit. Kjo, përveç estetikës jo të mirë, ngarkon edhe sistemin e kullimit të ujit atmosferik të sheshit.



Pjerrtësia e pllakave – Këndi i pjerrtësisë së pllakave pranë lokaleve afariste në shesh është vlerësuar i pamjaftueshëm e në disa vende nuk është i drejtuar drejt kanaleve të kullimit por drejt lokaleve afariste. Kjo rrit potencialin për grumbullim të ujit mbi sipërfaqe, krijim të pellgjeve me ujë dhe vërshimin e lokaleve gjatë motit me shi.



Mungesa e specifikacioneve për sistemim e ujitjes – Grupi i Auditimit Social, nuk ka arritur të gjejë specifikacione si (spërkatëse) dhe për sistemin e ujitjes – Konfirmohet nga komuna dhe kompania punëkryese se është planifikuar sistemi i ujitjes dhe mirëmbajtës së gjelbërimit.



Mungojnë WC-të publike – Në projektin e sheshit nuk janë planifikuar WC publike. Kjo do të krijojë sfida të konsiderueshme për përdoruesit, pakënaqësi në komunitet dhe pengesa për menaxhimin e sheshit. Përdoruesit, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit do të përballen me mungesë të një lehtësie themelore. Ata do të përdorin zona alternative si hapësira të gjelbra, cepa ndërtesash ose mure publike, duke shkaktuar probleme higjienike dhe vizuale.



Mbyllja e rrugës “Bedri Shala” –
Kjo vlerësohet se mund të
shkaktojë probleme për lokalet
afariste, shërbimet emergjente si

dhe për qarkullimin në përgjithësi. Lokalet
afariste do të kenë sfida furnizimi. Shërbimet
emergjente si ambulanca, zjarrfikësit. Ngjashëm
në projektim, nuk shihet si do të ofrohet qasja
për pjesën nga QKMF dhe banorëve për rrjedh
në shesh.

REKOMANDIME

Përmirësimi i vendosjes së pllakave dhe elementëve të kalldrëmit

- Kryerja e inspektimeve të detajuara dhe rregullimi i mënyrës së vendosjes së pllakave, anësoreve dhe kubëzave të vogla në përputhje me projektin fillestar. Kjo përfshin vendosjen e pllakave në formë rrethore duke u siguruar që ato të shtrihen në mënyrë të rregullt dhe të njëtrajtshme, duke ndihmuar kështu në estetikën dhe funksionalitetin e sheshit.

Përmirësimi i sistemit të kullimit të ujërave atmosferikë

- Të rishikohet dhe përmirësohet sistemi i kullimit të ujit atmosferik për të mundësuar një kapacitet më të lartë për menaxhimin e ujërave të shiut. Kjo përfshin instalimin e ujëmbledhësve më të gjerë dhe të përshtatshëm për të mundësuar shkarkimin e ujit, si dhe parandalimin e mundësisë së vërshimeve. Për më tepër, duhet të sigurohet një sistem i dedikuar i ujëmbledhësve për bizneset, për të shmangur ngarkesën mbi sistemin e sheshit.

Korrigjimi i pjerrtësisë së pllakave për kullimin e ujit

- Të rregullohet pjerrtësia e pllakave, duke i drejtuar ato drejt kanaleve të kullimit të ujit, për të parandaluar grumbullimin e ujit mbi sipërfaqe dhe për të ulur rrezikun e vërshimeve, sidomos pranë lokaleve afariste. Ky përmirësim do të mundësojë një kullim më të efektshëm të ujërave atmosferikë.

Krijimi i sistemit të ujitjes për gjelbërimin e sheshit

- Instalimi i një sistemi të ujitjes automatike për gjelbërimin e sheshit, për të siguruar mirëmbajtjen e drunjve dhe gjelbërimit. Kjo do të ndihmojë në mirëmbajtjen e hapësirave të drunjve dhe hapësirave të gjelbëruara.

Planifikimi i WC-ve publike

- Të rishikohet planifikimi fillestar dhe të instalohen WC-të publike në hapësirat përreth sheshit, për të siguruar lehtësi për përdoruesit, veçanërisht për fëmijët, të moshuarit dhe turistët. Kjo do të përmirësojë qasjen në shërbime publike dhe do të kontribuojë në menaxhimin e sheshit në mënyrë më efikase.

Rishikimi i vendimit për mbylljen e rrugës "Bedri Shala"

- Të shqyrtohet mundësia për mbajtjen e kësaj rruge në përdorim, të paktën për qarkullim të transportit për nevoja të furnizimit dhe të shërbimeve emergjente. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e qasjes së shpejtë për bizneset dhe shërbimet emergjente duke reduktuar kohën e reagimit të emergjencave.

Përmirësimi i bashkëpunimit me bizneset lokale

- Angazhimi dhe konsultimi me bizneset lokale gjatë zhvillimit të projektit për të siguruar që ata të kenë qasje të vazhdueshme dhe të mundësuar shërbimet e nevojshme pa pengesa. Ky bashkëpunim do të kontribuojë në zgjidhjen e çështjeve të mundshme, si dhe do të ndihmojë në menaxhimin e sheshit në mënyrë më efikase.

KOMENTET E KOMUNËS

Komentet e përgjithshme

Në takimin me Komunën, Grupi i Auditimit Social, ka prezantuar gjetjet dhe ndarë rekomandimet. Kryetari i Komunës, bashkë me ekipin, në takim ka thirrur edhe kompaninë punëkryese. Diskutimi u shtri në tri nivele: projektimin, zbatimin në terren si dhe propozimet përtej projektit. Komuna ka adresuar gjetjet dhe rekomandimet specifike.

Komentet Specifike:

- **Rekomandimi:** Përmirësimi i vendosjes së pllakave dhe elementëve të kalldrëmit
 - **Komenti i Komunës:** Komuna pajtohet me këtë vlerësim, duke theksuar se punimet ende nuk janë përfunduar dhe se ka mundësi për përmirësime. Kompania ka filluar të bëjë rregullimet e rekomanduara në vendosjen e pllakave, dhe kjo do të mundësojë përmbushjen e kërkesave të projektit. Komuna do të vazhdojë të monitorojë përparimin dhe të sigurojë që rregullimet të bëhen në përputhje me standardet e kërkuara.
- **Rekomandimi:** Përmirësimi i sistemit të kullimit të ujërave atmosferikë
 - **Komenti i Komunës:** Komuna vlerëson se janë bërë përgatitjet hidraulike dhe sistemi është i përballueshëm ndaj ujërave atmosferikë, sipas projektuesit. Kompania punëkryese ka siguruar që këto përgatitje janë në përputhje me standardet e kërkuara. Komuna do të vazhdojë të monitorojë ekzekutimin e këtyre punimeve për të siguruar që sistemi funksionon siç është planifikuar.
- **Rekomandimi:** Korrigjimi i pjerrtësisë së pllakave për kullimin e ujit
 - **Komenti i Komunës:** Komuna vlerëson se nuk ka pasur detaje të qarta në projekt për kullimin e ujërave të kulmeve të lokaleve përgjatë sheshit. Kompania është e informuar që kjo është përgjegjësi e bizneseve dhe se duhet të zgjidhet nga ato, por Komuna do të sigurohet që çdo veprim që mund të ndikojë në sheshin publik, të jetë i kontrolluar dhe të mos shkaktojë probleme në infrastrukturën përkatëse. Komuna konfirmon se pjerrtësia është në përputhje me pikat e nivelit të projektuesit. Ky aspekt është monitoruar dhe është vlerësuar që është realizuar siç është parashikuar në projekt, duke siguruar funksionalitetin dhe estetikën e sheshit.
- **Rekomandimi:** Krijimi i sistemit të ujitjes për gjelbërimin e sheshit
 - **Komenti i Komunës:** Komuna është e kënaqur me vendosjen e sistemit të ujit të gjelbërimit në sistemin pikë-pikë për secilën pjesë gjelbëruese të sheshit. Ky sistem kontribuon në ruajtjen e efikasitetit të ujit dhe do të monitorohet për të siguruar funksionimin e tij të duhur gjatë përdorimit.
- **Rekomandimi:** Planifikimi i WC-ve publike
 - **Komenti i Komunës:** Komuna do të shqyrtojë mundësinë për rregullimin e WC-ve publike në pjesën e lokaleve përballë QKMF-së, siç është propozuar. Ky rregullim është i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve për përdoruesit e sheshit dhe do të analizohet në detaje për të siguruar implementimin e tij.
- **Rekomandimi:** Rishikimi i vendimit për mbylljen e rrugës "Bedri Shala"
 - **Komenti i Komunës:** Komuna konsideron që rruga duhet të mbetet e mbyllur, pasi hapja e saj do të krijonte dy sheshe paralele me rrugë të ndarë, ndërsa projekti është parashikuar për të krijuar një shesh të vetëm. Komuna do të sigurohet që ky aspekt të respektohet në mënyrë që të ruhet koherenca e projektit dhe të evitohet ndarja e sheshit.

LISTA E GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	Tahir Krasniqi	Koordinator i Grupit
2	Anita Curri	Anëtar
3	Habib Mulaj	Anëtar
4	Edmond Berquku	Anëtar
5	Luan Elezi	Anëtar
6	Elez Elezi	Anëtar
7	Megjit Istogu	Anëtar
8	Arben Istogu	Anëtar
9	Krenar Nika	Anëtar
10	Arben Nika	Anëtar
11	Isak Nika	Anëtar
12	Stoik Qorri	Anëtar
13	Izet Abdyli	Anëtar
14	Donika Zogu	Anëtar
15	Florim Geci	Anëtar
16	Arben Veliu	Anëtar

